



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Gjeografi

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje** me **zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit


Pyetja	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Pyetja	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Pyetja	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Pyetja	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Pyetja	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Forma pothuajse sferike e Tokës ndikon në: **1 pikë**
 A) madhësinë e forcës së fërkimit.
 B) madhësinë e forcës së rëndesës.
 C) shpërndarjen zonale të ngrohtësisë.
 D) shpërndarjen zonale të baticave dhe zbaticave.
2. Një nga pasojat kryesore të rrotullimit të Tokës rresht boshtit të vet është: **1 pikë**
 A) ndryshimi i stinëve gjatë 365 ditëve.
 B) ndryshimi i kohës lokale dhe zonale.
 C) ndryshimi i vendndodhjes relative të Diellit kundrejt Tokës.
 D) ndryshimi i stinëve midis Hemisferës Jugore dhe Hemisferës Veriore.
3. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë lidhur me pozicionin e Tokës kundrejt Diellit të treguar në figurë? **1 pikë**
 A) Hemisfera Veriore ndriçohet më shumë sesa Hemisfera Jugore.
 B) Gjatësia e ditës është më e madhe në Hemisferën Veriore.
 C) Dita është e barabartë me natën në Tropikun e Veriut.
 D) Dita zgjat 24 orë në Polin e Jugut.
- 
4. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë për meridianin e Grinuiçit? **1 pikë**
 A) Meridiani i Grinuiçit ka vlerën 180°.
 B) Meridiani i Grinuiçit kalon pranë Londrës.
 C) Meridiani i Grinuiçit është më i gjatë se meridianët e tjerë.
 D) Në varësi të meridianit të Grinuiçit klima ndryshon nga ekuatoriale në polare.
5. Në cilat gjerësi gjeografike gjenden zonat me klimë ekuatoriale? **1 pikë**
 A) Në gjerësitë gjeografike 5° – 15°
 B) Në gjerësitë gjeografike 40° - 60°
 C) Në gjerësitë gjeografike 50° - 70°
 D) Në gjerësitë gjeografike 70° - 90°
6. Cili është faktori kryesor i formimit të baticave dhe zbaticave? **1 pikë**
 A) Forca tërheqëse e Hënës dhe e Diellit.
 B) Erërat e qarkullimit të përgjithshëm.
 C) Valët me lartësi të mëdha.
 D) Erërat periodike.
7. Pjesa më e madhe sipërfaqes së tokës mbulohet nga shkëmbinjtë: **1 pikë**
 A) sedimentarë.
 B) metamorfikë.
 C) magmatikë.
 D) granitikë.
8. Gnejset janë përfaqësues të shkëmbinjve: **1 pikë**
 A) sedimentarë argjilorë.
 B) sedimentarë kimikë.
 C) metamorfikë.
 D) magmatikë.
9. Cila nga alternativat e mëposhtme është karakteristike e shkëmbinjve magmatikë efuzivë? **1 pikë**
 A) Kanë pak kristale për shkak të ftohjes së shpejtë të magmës.
 B) Në këto lloj shkëmbinjsh bëjnë pjesë karbonatet dhe silicorët.
 C) Formimi i tyre vjen si pasojë e shkatërrimit-depozitimit-diagjenezës.
 D) Formohen nga veprimtaria jetësore e gjallesave bimore dhe shtazore.

- 10. Transgresioni detar shoqërohet me:** **1 pikë**
A) mbizotërimin e klimës kontinentale.
B) rritjen e sipërfaqes kontinentale.
C) kthimin e gadishujve në ishuj.
D) kthimin e ishujve në gadishuj
- 11. Cili nga tiparet e mëposhtëm është karakteristikë dalluese për rajonin e Evropës Veriore?** **1 pikë**
A) Mbizotërimi i maleve me moshë të vjetër.
B) Dalja e gjerë në brigjet e Detit të Zi.
C) Mbizotërimi i klimës mesdhetare.
D) Vija bregdetare pak e thyer.
- 12. Karakteristikë e zhvillimeve demografike në rajonin e Evropës Perëndimore është:** **1 pikë**
A) niveli i lartë i shtimit natyror të popullsisë.
B) mbizotërimi i popullsisë në moshë të re.
C) niveli i ulët i urbanizimit.
D) plakja e popullsisë.
- 13. Në lëvizjet e sotme migratore botërore fluksin më të madh të migrameve e kanë ato nga:** **1 pikë**
A) Evropa drejt Azisë.
B) Afrika drejt Evropës.
C) Amerika Latine drejt Azisë.
D) Afrika drejt Amerikës së Veriut.
- 14. Një qytet bregdetar ka përjetuar rritje të nivelit të detit dhe reshje më të shpeshta e intensive gjatë dhjetë viteve të fundit. Ekspertët paralajmërojnë se përmytjet e shpeshta mund të ndikojnë në zhvendosjen e popullsisë nga qyteti. Kjo situatë është pasojë e:** **1 pikë**
A) ngrohjes globale e cila ka përshpejtuar shkrijën e akullnajave dhe rritjen e nivelit të ujit.
B) prurjeve të shumta të lumenjve, të cilat kanë rritur rrezikun e përmytjeve.
C) zhvendosjes së reshjeve nga zonat kontinentale drejt zonave bregdetare.
D) ndërtimeve të dendura urbane pranë zonave bregdetare.
- 15. Zona më e populluar në Shqipëri është:** **1 pikë**
A) fushëgropa e Delvinës.
B) ultësira Perëndimore.
C) gropa e Pogradecit.
D) lugina e Vjosës.
- 16. Migrimi ndodh kryesisht për shkaqe:** **1 pikë**
A) ekonomike.
B) sociale.
C) politike.
D) fetare.
- 17. Sasia më e vogël e reshjeve në Republikën e Shqipërisë bie në:** **1 pikë**
A) Bogë.
B) Qafë – Shtamë.
C) Fushëgropën e Korçës.
D) Malësinë e Kurveleshit.

18. Njësia fiziko-gjeografike më e madhe e Rajonit Juglindor është:

1 pikë

- A) gropa e Kolonjës.
- B) fushëgropa e Korçës.
- C) fushëgropa e Përrenjasit.
- D) lugina e Devollit të Sipërm.

19. Cila nga alternativat e mëposhtme është karakteristike për Malësinë e Çermenikës?

1 pikë

- A) Ka reliev të ulët dhe të butë.
- B) Ndodhet pranë detit Adriatik.
- C) Dallohet për relievin shumë të copëtuar.
- D) Përbëhet kryesisht nga shkëmbinjtë magmatikë.

20. Kontrastet e theksuara të relievit në Alpet Shqiptare janë krijuar nga:

1 pikë

- A) veprimtaria vullkanike në të kaluarën.
- B) proceset gjeologjike dhe erozioni i fuqishëm.
- C) ndikimi i vazhdueshëm i njeriut në modifikimin e mjedisit natyror.
- D) ndryshimi i shkëmbinjve për shkak të temperaturave dhe trysnive të larta.

21. Figurat e dhëna tregojnë dy nga llojet e projeksioneve hartografike.




Fig.1




Fig.2

a) Emërtoni projeksionin hartografik që tregohet në figurën 1.

1 pikë


b) Si paraqiten meridianët dhe paralelet në projeksionin hartografik të paraqitur në figurën 1.

1 pikë

c) Cili nga projeksionet është më i përshtatshëm për paraqitjen e zonave në gjerësi të mëdha gjeografike?

1 pikë

- 22.** Figura tregon erërat e qarkullimit të përgjithshëm. Emërtoni erërat e qarkullimit të përgjithshëm që formohen në gjerësitë ekuatoriale, mesatare dhe polare. **3 pikë**



Në gjerësitë ekuatoriale: _____

Në gjerësitë mesatare: _____


Në gjerësitë polare: _____

- 23.** Përcaktoni tri nga kushtet kur veprimtaria karstike është më e zhvilluar. **3 pikë**

- 24.** Në figurë jepet ndërtimi i brendshëm i Tokës, në të cilën dallohen qartë tri shtresat kryesore të saj: korja e tokës, manteli dhe bërthama.

- a) Përcaktoni një tipar dallues të mantelit.

- b) Identifikoni dy ndryshime midis bërthamës së brendshme dhe asaj të jashtme.



- 25.** Era ndikon në ndryshimin e sipërfaqes së Tokës përmes veprimtarisë të saj shkatërruese.

- a) Si quhet veprimtaria shkatërruese e erës pa mbartur material?

- b) Identifikoni dy kushte kur kjo veprimtari është më e madhe.

26. Në rajonin e Australi-Oqeanisë ishujt e shumtë të Oqeanisë ndahen në disa grupe.

a) Cilët janë dy nga grupet kryesore të ishujve të Oqeanisë?

2 pikë

b) Evidentoni një tipar dallues të hidrografisë së Australisë.

1 pikë

27. Evidentoni tri nga veçoritë dalluese të hidrografisë së rajonit të Azisë Jugore.

3 pikë

28. Përcaktoni nga një tipar dallues të vijës bregdetare, relievit dhe klimës së Evropës Mesdhetare.

3 pikë

Vija bregdetare:

Relievi:

Klima:

29. Përcaktoni tri veçori të popullimit të rajonit të Azisë Lindore.

3 pikë

- 30.** Përcaktoni tri arsye pse lumenjtë e Shqipërisë kanë forcë të madhe gërryese dhe prurje të mëdha të ngurta. **3 pikë**

- 31.** Emigrimi i shqiptarëve pas viteve 1990 solli një sërë pasojash pozitive dhe negative, si për individët që emigruan ashtu dhe për familjet e tyre. Listoni tri nga pasojat pozitive të emigrimit. **3 pikë**

- 32.** Në pasurinë hidrografike të Shqipërisë bëjnë pjesë dhe lagunat

- a) Identifikoni një nga lagunat në Shqipëri. **1 pikë**

- b) Përcaktoni dy nga karakteristikat e lagunave. **2 pikë**

- 33.** Në cilin rajon gjeografik bëjnë pjesë kodrat e Mallakastrës? Listoni tri karakteristika fiziko-gjeografike të tyre. **4 pikë**

Rajoni gjeografik:

Tri karakteristikat:
